

VLERËSIMI I NXËNËSIT/KURSANTIT SIPAS
KËRKESAVE TË KURRIKULËS SË AFP-së DHE
NËPËRMJET TEKNIKAVE ONLINE.

QËLLIMI:

- Krijimi te mësuesit dhe instruktorët e Institucioneve ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional (IoAFP) i aftësive profesionale për planifikimin dhe përdorimin e efektshëm të teknikave të vlerësimit formues, motivues, matës, si dhe teknikave online të vlerësimit të nxënësve/kursantëve.

REZULTATET E PRITSHME:

Në fund të trajnimit pjesëmarrësit të jenë të aftë të:

- shpjegojnë se ç'është vlerësimi si proces dhe si matje
- shpjegojnë se çfarë nënkuptojmë me vlerësimin për të nxënë dhe vlerësimin e të të nxënit
- identifikojnë llojet e vlerësimit dhe t'i shpjegojnë ato
- identifikojnë veprimtaritë që vlerësohen dhe t'i shpjegojnë ato
- paraqesin teknika që vlerësojnë procesin e të të nxënit
- paraqesin teknika që vlerësojnë të nxënit
- bëjnë dallimet midis teknikave që vlerësojnë të nxënë dhe të nxënit
- analizojnë teknikat që përdor një mësues në një situatë të dhënë, për të dalluar nëse janë teknika për të nxënë apo të të nxënit
- japin gjykimet e tyre për rëndësinë që ka vlerësimi për të nxënë dhe i të nxënit në një orë mësimore
- shqyrtojnë në raste të ndryshme të përdorimit të teknikave të vlerësimit, duke dhënë gjykime personale
- analizojnë teknika të vlerësimit në kushtet e mësimdhënies online

Pse duhet vlerësimi?

- **Proces**
- **Matje**
- **Nivel të nxëni/arritje**
- **Transferim**
- **Regjistrim**
- **Akreditim**

Parimet e vlerësimit

- Vlerësimi duhet të jetë pjesë integrale e praktikave më të mira të procesit të mësimdhënies dhe nxënies.
- Vlerësimi duhet të jetë një veprimtari e planifikuar dhe e vazhdueshme.
- Vlerësimi duhet të reflektojë rezultatet e pritshme të kurrikulës.
- Vlerësimi duhet të ndihmojë mësuesit/instruktorët në përmbushjen e nevojave individuale si dhe në ofrimin e programeve të përshtatshme për nxënësit/kursantët.
- Vlerësimi duhet të përfshijë jo vetëm matjen, por edhe interpretimin dhe gjykimin.
- Vlerësimi duhet të jetë i ndjeshëm ndaj dallimeve social-demografike të tilla si ato kulturore, gjinore dhe vendodhje gjeografike.
- Vlerësimi duhet të përdorë teknika vlerësimi për qëllime formuese, diagnostikuese, përmbledhëse.
- Vlerësimi duhet të japë informacion brenda fushës njohëse, afektive dhe psikomotore.
- Vlerësimi duhet të respektojë dhe mbrojë konfidencialitetin e informacionit mbi nxënësin/kursantin.
- Vlerësimi duhet të jetë i drejtë, i paanshëm dhe i barabartë, duke u dhënë të gjithë nxënësve /kursantëve mundësinë për të demonstruar gamën e dijeve, aftësive dhe mundësive të tyre.
- Vlerësimi duhet të ushqejë aftësitë e nxënësve/kursantëve për të transferuar dijet e tyre në përvoja jetësore.
- Vlerësimi duhet të komunikohet rregullisht me prindërit/kujdestarët dhe nxënësit/kursantët në një mënyrë sa më kuptimplotë.

LLOJET E VLERËSIMIT

- **DIAGNOSTIKUES**
- **MOTIVUES/I VAZHDUESHËM**
- **MATËS/PËRFUNDIMTAR**

VLERËSIMI NË IoAFP

Drejtimit e vlerësimit të nxënësve/kursantëve të IoAFP-të	Treguesit e vlerësimit
1.Vlerësimi periodik i nxënësit/kursantit	1.Mësuesi/instruktori dokumenton vlerësimin për të nxënë të nxënësit/kursantit 2. Mësuesi/instruktori zhvillon vlerësime me test/detyra përmbledhëse për të matur nivelin a rritjeve të nxënësit/kursantit 3. Mësuesi/instruktori realizon vlerësim të nxënësit/kursantit duke u bazuar në portofilin e tij.
2.Vlerësimi përfundimtar i nxënësit/kursantit	1.Mësuesi/instruktori kryen vlerësimin përfundimtar të nxënësit/kursantit 2. Mësuesi/instruktori vlerëson nxënësit në Provimet Përfundimtare të Nivelit I, II dhe III në Arsimin Profesional.
3.Procesi i vlerësimit	1. Mësuesi/instruktori ka një program të qartë për vlerësimin e nxënësve/kursantëve. 2. Mësuesi/instruktori bën vlerësimin e nxënësve/kursantëve për qëllime të ndryshme.
4.Arritjet	1.Rezultatet e nxënësve në Maturën Shtetërore përputhen në nivele të kënaqshme me vlerësimin e bërë nga shkolla e AFP. 2. Rezultatet e nxënësve në Provimet Përfundimtare të Nivelit I, II dhe III në Arsimin Profesional përputhen me vlerësimin e bërë gjatë vitit mësimor. 3. Mësuesi/instruktori informon prindërit për rezultatet e nxënësve dhe kursantëve
5.Rivlerësimi	1. IoAFP-ja zhvillon procedura rivlerësimi për nxënësit/kursantët konform akteve ligjore
6.Ankimimet	1.IoAFP-ja u përgjigjet ankimimeve të nxënësve/kursantëve për vlerësimin e tyre

METODA DHE TEKNIKA TË VLERËSIMIT FORMUES

- Stacionet e vlerësimit
- Vlerësimi individual
- Vlerësimi në grup
- Kontratat
- Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i bashkënxënësve
- Portofoli
- Detyrat me shkrim
- Prezantimet
- Detyra e shtëpisë
- Përshkrimi i pyetjeve me alternativa të shumta

METODA DHE TEKNIKA VLERËSIMIT ONLINE PËR VLERËSIMIN E TË REZULTATEVE TË TË NXËNIT

1. Teste elektronike dhe *kuize on-line*

2. Portofoli digjital

(Quiz në MësoVET, google forms)

JU FALEMINDERIT